

Ekzistojnë organizata të cilat do të të ndihmojnë po qe se ke rënë në vështirësi. Adresat e tyre i ke këtu më poshtë:

Shoqata Feterët Kundër Tregtis së Femrave
(Stichting Religieuze Tegen Vrouwenhandel)
Sint Janssingel 92
NL 5211 DA Den Bosch
The Netherlands (Holland)
Tel: +31-73 – 615-44 44
Fax: +31-73 – 615 44 49
E-mail: srtv@srtv.info
Faqja e internetit: www.srtv.info
Numri llogarisë së bankës: 420557 t.n.v.
SRTV

Po qe se ke nevojë për ndihmë në Gjermani:

Solwodi (Solidarity with Women in Distress)
Probstei-Strasse 2
D-54154 Boppard Hirzenach
Deutschland
Tel.: +49 – 67 41 22 32
Fax: + 49 – 67 41 23 10
E-mail: solwodi@t-online.de
Internet: <http://www.solwodi.de>

A ËSHTË EUROPA PARAJSË?



MOS U BESO TË GJITHA PËRRALLAVE!




Shoqata
Fetarët
Kundër
Tregtisë së Femrave



Albanian / Shejip

PARALAJMËROHEN
FEMRAT!

A TË PREMTON DIKUSH
ARDHMËRI MË TË MIRË
NËSE VJEN NË
EVROPËN
PERËNDIMORE?



Kjo fletushkë u kushtohet femrave që vijnë nga vendet në zhvillim dhe nga Evropa Lindore për t'i paralajmëruar kundrejt rrezikut të mundshëm që mund t'u kanoset nëse mërgojnë në shtetet e Evropës Perëndimore.

KËTO GJËRA DUHET T'I DIJSH...

Shumë femra i kanë të njejtat ëndrra si edhe ti.

Maria

Maria jetonte në varfëri. Për çdo ditë duhej të luftonte për të fituar diçka për jetesë. Gjatë tërë kohës ajo shpresonte në një jetë më të mirë. Prandaj një ditë ajo e shfrytëzoi rastin. Firmosi një kontratë te një agjenci. Kjo i ofroi një vend të mirë pune në Evropën Perëndimore. Me fitime të majme. Ajo mendonte se si valltare folklorike mund t'i largohej të keqes. Pas arritjes në Holandë zbuloi se të gji-tha ëndrrat kishin qenë një mashtrim. Në vend të vendit të ofruar të punës ajo u detyrua që të punojë në një sex-klub.

Theresa

Theresa u regjistrua në një klub për letërkëmbime. Në atë mënyrë ajo shpresonte se do të gjente një burrë të pasur. Miku me të cilin këmbente letra e ftoi atë të shkonte në Gjermani. Kur arriti atje, dëshprimi i saj ishte i madh. Atëherë pa se burri i saj i ardhshëm jo vetëm që ishte shumë më i mo- çëm se ajo por dhe se ishte edhe alkoolist. Ai e keqtrajtoi atë.

Lita

Një turist Belg i premtoi Litës një punë si sekretarëshë në hotelin e tij. Kur arriti ajo në Belgjikë, ai menjëherë ia mori pasaportën. Pastaj ajo u detyrua të punonte në prostitucion.

Kërko informata dhe ndihmë nga personi që ta ka dhënë këtë fletushkë!

PSE BËHET KY PARALAJMËRIM?

Në të gjitha shtetet e Evropës Perëndimore hasim numër shumë të madh grashë dhe vajzash nga shtetet e jashtme që kanë rënë në duar të këqia.

Atyre u është premtuar:

- një punë e mirë
- një rrogë e lartë
- një martesë e lumtur
- e të tjera e të tjera.

Ato mendojnë se për kohë të shkurtër do të bëhen të pasura. Se pastaj do të mund të kthehen në vendin e tyre të prejardhjes për t'u ndihmuar anëtarëve të varfër të familjes.

POR SI DUKET SHPESHHERË REALITETI?

1. Është vështirë të gjendet punë për shkak të papunësisë së madhe që ekziston edhe në Evropën Perëndimore.
2. Të nevojitet një leje pune, leje për qëndrim ose vizë. Në rast të kundërt ekziston rreziku që të kthejnë.
3. Shumë femra paguhen më pak se sa duhet; shpeshherë femrat zhyten në prostitucion.
4. Premtimet e bukura janë të rreme dhe nuk plotësohen. Ki kujdes!



Bindu në radhë të parë se dokumentet i ke në rregull

NËSE MEGJITHATË DON TA NDËRMARRËSH ATË HAP...

1. Bindu më parë se i din emrat dhe adresat e njerëzve që të bëjnë propozime. Informohu se a kanë qëndrim legal (të ligjshëm) apo jo.
2. Kërko kontakt me ambasadën e shtetit ku do të shkosh. Pyet atje se a njihet punëdhënësi ytë i ardhshëm dhe se a është njeri i besueshëm.
3. Kërko kontakt me grupe/organizata në vendin tënd që meren me mërgimtarët. Mundohu që të marrësh sa më tepër informata. Ndihma e tyre mund të të jetë e nevojshme po qe se kthehesh prapë.
4. Njofto familjen dhe miqtë se me cilën datë do të nisesesh, jepjua atyre adresën tënde të ardhshme, emrat e njerëzve me të cilët do të udhëtosh dhe një fotografi tënden që ke bërë para pak kohësh.
5. Po qe se bie në probleme, kërko një avokat. Sipas marrëveshjeve ndërkombëtare ke të drejtë që të marrësh avokat pa pagesë.
6. Në disa shtete policia ndihmon për ta luftuar tregtinë e femrave, edhe në rast se ato nuk i kanë dokumentet e vlefshme. Ata mund të të ndihmojnë.

Pasaporta është pronë e jote!

Mos ia jep kurrë pasaportën dikujt!